

Snezhana Trajanoviq
Bllagica Stojmanovska

MAKINAT DHE APARATET
NË
INDUSTRINË E KËPUCËVE

Viti III

Drejtimi tekstil-lëkurë
Teknik për këpucë

MAKINAT DHE APARATET NË INDUSTRIJË E KËPUCËVE
Botimi i parë

Autorë:
Snezhana Trajanoviq, inxh. e dipl.
Bllagica Stojmanovska, inxh. e dipl.

Recensentë:
Prof. dr. Lidija Naumovska
Prof. Ollgica Velkoviç
Prof. Zagorka Vogdanska

Përkthyes:
Abdylmexhit Shaqiri

Redaktor i botimit në gjuhën shqipe:
Prof. dr. Abdyl Koleci

Lektor:
Abdulla Mehmeti

Përgatitja kompjuterike:
Nikolla Trajanoviq

Përgatitja teknike e fotografive:
Risto Trajanoviq

Botuesi: Ministria e arsimit dhe shkencës e Republikës së Maqedonisë

Shtypi: Graficki centar dooel, Shkup

Me Vendim për miratimin e tekstit mësimor për lëndën Makinat dhe aparatet në industrinë e këpucëve, për vitin e tretë, drejtimi: Tekstil-lëkurë, profesioni: Teknik për këpucë, nr. 22-1006/1, i datës 14.06.2011, të miratuar nga Komisioni nacional për libra shkollorë.

CIP - Katalogizacija vo publikacija
Nacionalna i univerzitetaska biblioteka "Св.Климент Охридски", Скопје
АВТОР: Трајановиќ, Снежана - автор
ОДГОВОРНОСТ: Стојмановска, Благица - автор
НАСЛОВ: Машини и апарати во индустријата за обувки за III година текстилно-кожарска струка : техничар за обувки
ИМПРЕСУМ: Скопје : Министерство за образование и наука на Република Македонија, 2011
ФИЗИЧКИ ОПИС: 96 стр. : илустр. ; 28 см
ISBN: 978-608-226-306-9
УДК: 685.34.05(075.3)
ВИД ГРАЃА: монографска публикација, текстуална граѓа, печатена
ИЗДАВАЊЕТО СЕ ПРЕДВИДУВА: 07.11.2011
COBISS.MK-ID: 89112842

PËRMBAJTJA

Hyrje.....	7
TEMA: I MAKINAT ME SHTEP TË THJESHTË PËR PËRBËRJEN E PJESËVE TË SIPËRME TË – ËPUCËVE.....	9
1. MAKINAT PËR PËRBËRJEN E PJESËVE TË SIPËRME TË KËPUCËVE - KARAKTERISTIKAT E PËRGJITHSHME.....	10
1.1. MAKINA ME SHTEP TË THJESHTË.....	11
1.1.1. MEKANIZMAT KRYESORË DHE MEKANIZMAT NDIMËS TE MAKINAT ME SHTEP TË THJESHTË-TË ZAKONSHËM.....	12
1.1.2. MEKANIZMI LËVIZËS.....	14
1.1.3. MEKANIZMI I GJILPËRËS.....	15
1.1.4. LLOJET E GJILPËRAVE, PËRBËRJA E TYRE DHE QËLLIMI.....	16
1.1.5. MEKANIZMI I TRANSPORTIT.....	19
1.1.6. MEKANIZMI PËR DHËNIEN DHE SHTRËNGIMIN E PENIT.....	21
1.1.7. MEKANIZMI PËR PËRFORCIMIN E GJILPËRËS NË “GJILPËRORE”	22
1.1.8. MEKANIZMI PËR LËVIZJEN E “GJILPËRORES” TE MAKINAT ME SHPEJTËSI TË MADHE	24
1.1.9. MEKANIZMI I DRUGËZËS.....	25
1.1.9.1 LËVIZJA OSCILUESE	26
1.1.9.2 LËVIZJA RROTULLUESE.....	27
1.1.10. MEKANIZMI I GJILPËRËS TE MAKINA ZIG-ZAG.....	28
1.1.11. MKANIZMI I GJILPËRAVE TE MAKINA DY GJILPËRËSHE.....	30
1.1.12. MEKANIZMI I MAKINËS “NGJITËSE” – PASPULIM.....	31
1.1.13. MEKANIZMI NDIHMËS TE MAKINA ME SHTEP TË ZAKONSHËM.....	34

1.1.13.1 MEKANIZMI PËR RREGULLIMIN E DISTANCËS NË MES DY SHPIMEVE.....	34
1.1.13.2 MEKANIZMI PËR MBËSHTJELLJEN E PERIT NË MASURË....	35
1.1.13.3 MEKANIZMI PËR FTOHJEN E GJILPËRËS.....	37
TEMA: II MAKINA PËR TËRHEQJE – PËRBËRJEN E PJESËS SË SIPËRME ME TABANICË.....	38
2. MAKINA PËR TËRHEQJE – PËRBËRJEN E PJESËS SË SIPËRME ME TABANICË.....	39
2.1. MEKANIZMAT TE MAKINAT PËR PARATËRHEQJE DHE TËRHEQJE TË MAJËS... 40	40
2.2. MEKANIZMAT E DARAVE.....	42
2.3. MEKANIZMAT E MBAJTËSIT TË POSHTËM.....	43
2.4. MEKANIZMI PER DHËNIEN E GOZHDAVE OSE NGJITËSEN.....	44
2.5. MEKANIZMI PËR NGULJEN E GOZHDAVE.....	45
TEMA: III MAKINA PËR TËRHEQJEN E THEMBRËS AUTOMATIKE- KARAKTERISTIKAT E PËRGJITHSHME TË MAKINËS PËR TËRHEQJEN E THEMBRËS.....	46
3. KARAKTERISTIKAT E PËRGJITHSHME TË MAKINËS PËR TËRHEQJEN E THEMBRËS.....	47
3.1. MEKANIZMI I MBAJTËSIT TË POSHTËM.....	48
3.2. MEKANIZMI SHTRËNGUES.....	49
3.3. MEKANIZMI I PLLAKAVE.....	50
3.4. MEKANIZMI I MBAJTËSIT TË SIPËRM.....	51
3.5. MEKANIZMI PËR DHËNIEN E GOZHDAVE.....	52
3.6. MEKANIZMI PËR NGULJEN E GOZHDAVE.....	53

TEMA: IV MAKINA PËR LARGIMIN E RUDHJEVE DHE LËSHIMEVE	
GJATË TËRHEQJES	54
4.1 MEKANIZMI TE MAKINA ME UNAZA - „SHALLUVANJE” (RRAFSHIMI).....	55
4.2. MEKANIZMI TE MAKINA ME ÇEKAN – RRAHJE.....	57
4.3. MEKANIZMI TE MAKINA PËR GRITHJE.....	59
4.4. PAISJA PËR THITHJEN E MBETURINAVE.....	61
4.5. MEKANIZMI PËR MPREHJEN E THIKËS TE MAKINA PËR NDARJE (SHPALLT).....	62
TEMA: V MAKINAT PËR PËRBËRJEN E PJESËVE TË SIPËRME DHE TË POSHTME TË MBATHJEVE.....	63
5.1. MEKANIZMAT KRYESORË TE MAKINAT PËR PËRFORCIM TË NËNTHEMBRAVE.....	64
5.2. MEKANIZMI PËR NGULJENE GOZHDAVE TE MAKINAT PËR PËRFORCIMIN E NËNTHEMBRAVE.....	67
5.3. MAKINA PËR PËRFORCIMIN E NËNTHEMBRAVE ME VIDË.....	68
TEMA: VI MAKINAT PËR BASHKIMIN E GJYSMËPOHIMIT ME PJESËN E SIPËRME.....	70
6.1 MEKANIZMI PËR BASHKIMIN E GJYSMËPRODHIMIT ME GJONIN –(ME PRESË).....	71
6.2. MEKANIZMI PËR BASHKIMIN E GJONIT ME GJYSMËPRODHIMIN ME VULLKANIZIM.....	73

TEMA: VII MAKINA PËR PËRFUNDIMIN E PJESËVE TË

POSHTME – FINALIZIMI..... 75

7. KARAKTERISTIKAT E PËRGJITHSHME PËR PËRFUNDILMIN E PJESËVE TË

POSHTME..... 76

7.1. MEKANIZMI TE MAKINA PËR GLODIM (RRAFSHIM -LËMIM)..... 77

7.2. MAKINA PËR PËRFUNDIMIN E PJESËVE TË POSHTME..... 78

TEMA: VIII KUSHTET PËR PUNË NË INDUSTRIJËN E

MBATHJEVE – KËPUCËVE..... 81

8. KUSHTET PËR PUNË NË INDUSTRIJËN E KËPUCËVE..... 82

PYETJE PËR KONTROLLIMIN E DITURISË PËR TEMAT..... 88

LITERATURA..... 95

Hyrje

Teksti është përpiluar në bazë të planit dhe programit mësimor dhe fondit të orëve në dispozicion për nxënësit e vitit të tretë të **profesionit tekstil-lëkurë** – profili **teknik i mbathjeve-këpucëve**.

Qëllimi i këtij libri është që të ndihmojë në marrjen e mjeteve dhe metodave të punës në procesin teknologjik në industrinë e këpucëve. Paralelisht me prezantimin e koncepteve teorike dhe metodave, janë të paraqitura dhe fotografitë, modelet dhe skicat me sqarime dhe analiza.

Sot, në prodhimin industrial të këpucëve përdoret një numër i madh i makinave pneumatike dhe hidraulike, si kombinim në mes të atyre elektromekanike, si dhe makina hidraulike. Në shumicën e rasteve të kaluara, lidhjet në mes pajisjeve të ndryshme janë kryer me përdorimin lakor të ndryshëm dhe mekanizma të tjerë. Por, përveç kësaj, sot përdoren makina hidraulike, pneumatike, mekanizma elektronikë dhe e lehtësojnë procesin duke punuar me makinë.

Makinat e kanë zëvendësuar punën e rëndë fizike të punëtorëve, duke kontribuar për ta zgjeruar prodhimtarinë dhe rritjen e numrit të madh të produkteve të lira. Me përdorimin e makinave gjysmëautomatike, automatike, puna fizike e punëtorit bije në minimum, por duhet të rritet nevoja për më shumë edukim dhe profesionalizim i këtyre punëtorëve që do të punojnë me makinat e përsosura.

Autorët

TEMA: I

MAKINAT ME SHTEP TË THJESHTË PËR
PËRBËRJEN E PJESËVE TË
SIPËRME TË- KËPUCËVE

1. MAKINAT PËR PËRBËRJEN E PJESËVE TË SIPËRME TË KËPUCËVE-KARAKTERISTIKAT E PËRGJITHSHME

Në këtë grup bëjnë pjesë shumë lloje të ndryshme të makinave. Duke u varur nga karakteristikat e tyre teknike dhe operative mund të grupohen në grupe të ndryshme varësisht prej karakteristikave. Në industrinë e këpucëve përdoren lloje të ndryshme të makinave.

Makinat industriale për qepje janë grupi më i madh dhe me lloje të ndryshme të makinave dhe ato mund të ndahen sipas:

- shpejtësisë së lëvizjes - numri i shpimeve në minutë
- llojet e shpimeve
- numrit të gjilpërave që përdoren për makinën
- llojeve e mekanizmave transportues
- mënyra e mirëmbajtjes

Sipas konstruksionit, makinat për qepje mund të ndahen në:

- makina të thjeshta
- makina speciale për qepje-të veçanta
- makina automatike

Sipas metodës së përdorimit ndahen në:

- makina shtëpiake
- makina artizanale
- makina industriale

1.1. MAKINA ME SHTEP TË THJESHTË

Makinat e thjeshta përçepje në industrinë prodhuese janë paraparë të përdoren me një gjilpërë që ka një vrimë dhe përdoren me një pe të sipërm dhe një pe të poshtëm për çepje.

Sipas llojit të çepjes-shtepit, këto makina janë të ndara në:

- makinë me shtep të thjeshtë-të zakonshëm (300-301)
- makinë me shtep zigzag (302)
- makinë me dy pena - „dygjilpërëshe“ (400)
- makinë me shtep verigë (100)
- makinë me shtep verigë nga ana e sipërme (101)
- makinë me shtep verigë nga ana e poshtme (102)

Sipas shpejtësisë, makinat janë të ndara në:

- makina me shpejtësi të vogël 500 - 1500 r / min.
- makina me shpejtësi normale 2000 - 3000 r / min.
- makina me shpejtësi të madhe 3000 - 6000 r / min.

1.1.1. MEKANIZMAT KRYESORË DHE MEKANIZMAT NDIHMËS TE MAKINAT ME SHTEP TË THJESHTË-TË ZAKONSHËM



Figura 1. Makina me shtep të thjeshtë-të zakonshëm

Të gjitha makinat për përbërjen e pjesëve të sipërme janë të përbërë nga tre pjesë, dhe ato janë:

- **pjesa e punës** – koka e makinës,
- **pjesa lëvizëse** – elektromotori me mekanizmin e transmetimit,
- **pjesa ndihmëse** - mjetet ndihmëse dhe pajisjet.

Pjesa e punës - koka e makinës paraqet pjesën kryesore e cila quhet pjesa bazë ose boshti lëvizës. Nga ana e djathtë gjendet rrota-transmetuesi me ndihmën e rripit që është i lidhur me **pjesën lëvizëse të** makinës. Në pjesën e punës është elektromotori i cili me ndihmën e mekanizmit transmetues – rripit, i vë në lëvizje

pjesët e makinës që të kryejë detyrën e saj. Pjesët ndihmëse shërbejnë për lehtësimin e punës së makinës dhe më lehtë të udhëheqë punëtori me makinën.

Çdo makinë ka një mekanizëm ndihmës, kryesorë.

Në grupin e mekanizmit kryesorë janë:

- mekanizmi i punës
- mekanizmi i gjilpërës
- llojet e gjilpërave, qëllimi dhe puna e tyre
- mekanizmi i transportit
- mekanizmi për dhënie dhe shtrëngimin e perit
- përforcimi i gjilpërës në "gjilpërore"
- mekanizmi për lëvizjen e gjilpërës
- mekanizmi i drugëzës
- mekanizmi i gjilpërës te makina zigzag
- mekanizmi i gjilpërave - „dygjilpërshë“
- mekanizmi për makinën paspulir dhe „ngjitëse“

Në grupin e mekanizmave ndihmës bëjnë pjesë:

- mekanizmi për rregullimin e distancës në mes dy shpimeve
- mekanizmi për mbështjelljen e perit në drugëz-spirale
- mekanizmi për ftohjen e gjilpërës

1.1.2. MEKANIZMI LËVIZËS

Këtë mekanizëm e përbën motori elektrik që ka fuqi të vogël, por numër të madh të rrotullimit në minutë. Në fund të motorit elektrik gjendet boshti, boshti kryesorë është i përbërë prej dy pjesëve të lidhura mes veti me mekanizëm. Mekanizmi prej dy pjesëve afrohen dhe largohen dhe kështu mundëson lëvizjen e motorit elektrik për të transmetuar ose të mos transmetojë lëvizjen në boshtin kryesorë. Mekanizmi dypjesësh përfshin përdorimin e një papuçe të veçantë. Kjo papuçe më tepër është nën këmbë.




Figura 2. Skema e mekanizmit lëvizës

Gjysmëprodhimi vendoset në tavolinën e punës dhe duke e përdorur shputën e këmbës në pedale për ta aktivizuar mekanizmin dypjesësh. Pastaj me lëvizjen e motorit elektrik bartet në lëvizje në transmetuesin e boshtit kryesor. Me ndihmën e mekanizmit të lakuar lëvizja harkore bartet në lëvizje të drejtë dhe si e tillë nëpërmes motorit ose me lëvizje të boshtit transmetohet deri te mbajtësit dhe me atë deri te gjilpëra. Ky vendim të mekanizmit transmetues mundëson vetëm një nisje (startim) të makinës gjatë kohës së punës. Kjo kontribuon që motori elektrik gjithmonë të punojë, kurse lëvizja të mos bartet në boshtin kryesor. Me këtë, kohëzgjatja e

makinës rritet për shkak se varet prej numrit të nisjes (startimit) dhe ndërprerjes të makinës.

1.1.3. MEKANIZMI I GJILPËRËS

Mekanizmi i gjilpërës, si dhe të gjithë mekanizmat tjerë kanë lëvizje të sinkronizuar. Lëvizja e sinkronizuar është lëvizje e dy ose më shumë mekanizmave të lidhura, reciprokisht në një tërësi-bashkësi. Lidhja e mekanizmave duhet të jetë e përcaktuar paraprakisht. Nëse nuk është lëvizja e sinkronizuar mund të vijë deri te gërshetimi i perit. Për shembull: nëse distanca në mes gjilpërës dhe drugëzës është më e madhe se 0.1 mm, nuk mund të formohet lidhje, në rast se distanca është më e vogël, vjen deri të thyerja e gjilpërës.

1. Motori elektrik
2. Boshti kryesor
3. Mekanizmi i lakuar
4. Kushineta
5. Aksi i motorit
6. Mbajtësi i gjilpërës
7. Pjesa e sipërme
8. Mekanizmi i gjilpërës




Figura 3. Pamja skematike e mekanizmit të gjilpërës

Me nisjen (startimin) e makinës, ajo e vë në lëvizje edhe motorin elektrik i cili fillon të jep lëvizje rrethore. Kjo lëvizje e motorit elektrik fillon kur punonjësi duke e shtypur këmbën mbi papuçë dhe e vë në lëvizje mekanizmin transportues. Me vënien në lëvizje të mekanizmit transportues, lëvizjet rrethore të motorit elektrik me ndihmën e lëvizjes të sinkronizuar, mekanizmat ndihmës transmetohen në lëvizje

drejtvizore. Lëvizja drejtvizore bartet në gjilpërë me ndihmën e mekanizmit të lakuar dhe aksit motorik deri te mekanizmi i gjilpërës. Në vetë mekanizëm, së pari prej aksit të motorit, lëvizja transferohet në mbajtësin e gjilpërës, dhe me këtë në gjilpërë. Pas mbarimit të këtij procesi të komplikuar, gjilpëra fillon me punën e saj.

1.1.4. LLOJET E GJILPËRAVE, PËRBËRJA E TYRE DHE QËLLIMI

Gjilpëra – është mjet që kryen qepjen e pjesëve të sipërme të këpucëve. Gjilpërat e makinave kanë kërkesë të madhe në praktikë për industrinë e këpucëve. Gjilpërat janë të përbëra prej çeliku me cilësi të lartë. Ka disa lloje të gjilpërave të cilat dallohen sipas:

- madhësisë
- formës së majës
- trashësisë
- mënyrës së përpunimit

Më së shumti, ndarja bëhet sipas mënyrës të përpunimit:

- mënyra amerikane
- mënyra gjermane

Mënyra amerikane e përpunimit:

Këto gjilpëra janë të përbëra prej çeliku me cilësi të lartë me metodën e ftohtë të përpunimit – tërheqjen e gjilpërës. Gjatësia e këtyre gjilpërave është më e madhe në krahasim me gjilpërat tjera. Pas procesit të tërheqjes duhet të kryhet përpunimi i gjilpërës në mënyrë mekanike dhe termike që të përfitohet përforcimi plotësues i

gjilpërës. Gjithashtu, duhet të kryhet edhe përpunimi për të mbrojtur sipërfaqen e vetë gjilpërës.

Mënyra gjermane e përpunimit:

Dallimi në mes gjilpërave amerikane është në mënyrën e përfitimit të gjilpërës. Në këtë rast bëhet fjalë për gjilpërë të përfituar me mënyrën e nxehtë të vetë gjilpërës. Gjatësia është më e vogël në krahasim me gjilpërën amerikane. Në krahasim me fortësinë, gjilpërat gjermane më lehtë thyhen dhe kanë elasticitet të dobët.

Gjilpërat ballafaqohen me ngarkesë më të madhe gjatë procesit të qepjes në temperatura të larta dhe fërkim. Në 8-10 sekondat e para te makinat me shpejtësi të ulët arrin deri te rritja e temperaturës së gjilpërës prej 240-260°C, kurse te makinat me shpejtësi të lartë arrin temperaturën deri 400°C. Në këto temperatura duhet të arrijë një balancë e ftohjes - nxehjes që të mos vijë deri te dëmtimi i materialit. Në këtë rast, në qoftë se vjen në nxehje të tepërt të gjilpërës, ajo vet në material do të fillojnë të krijojë vrima me hapësirë më të gjerë se trashësia e saj, ku formon qepje të parregullt-paqëndrueshme. Që të mos vijë deri te ky fenomen i padëshiruar, gjilpëra duhet të ftohet duke përdorur mënyrën e ftohjes. Pajisjet më të zakonshme që përdoren janë kompresorët me ajër, ose preparatet tjera kimike - puferë për ftohje të gjilpërës. Këto pajisje janë të montuar në vetë mekanizmin dhe në vetë lëvizjen e gjilpërës, ajo zhytet vetë në lëngun ose përsëri ftohet me ajrin e ngjeshur që është sjellë pranë gjilpërës duke përdorur një sistem të kanaleve. Këto mekanizma më së shpeshti janë të ngulitur në makinë me shpejtësi të ulët në makinat që përdoren për qepjen e materialeve sintetike.

1. Koka e gjilpërës
2. Trupi i gjilpërës
3. Maja e gjilpërës




Figura 4. Pamja skematike e gjilpërës së makinës

Gjilpëra ka një prerje të gjatë dhe të shkurtër. Prerja e gjatë shërben për hyrjen e perit, kurse prerja e shkurtë shërben për gërshetim dhe krijimin e vjegzës-nyjës.

1.1.5. MEKANIZMI I TRANSPORTIT

Ky mekanizëm ka për detyrë ta shtyjë dhe lëviz materialin gjatë qepjes. Mekanizmi i transportit është i përbërë prej pedales së sipërme në pjesën e jashtme dhe pedales në pjesën e poshtme të brendshme e cila është e dhëmbëzuar.

1. Motori elektrik
2. Boshti kryesor
3. Mekanizmi i lakuar
4. Kushineta
5. Aksi
6. Mbajtësi i gjilpërës me kokë
7. Mekanizmi
8. Doreza për ngritje
9. Papuçja e sipërme transportuese
10. Shtylla punuese
11. Pedale e brendshme poshtë e dhëmbëzuar
12. Mekanizmi i lakuar
13. Unaza e repartit
14. Lakori në formë të pirunit-Grremçi




Figura 5. Skema mekanizmit transportues

Mekanizmin e sipërm të jashtëm e përbëjnë pedala transportuese e sipërme që ka për detyrë ta shtyjë materialin drejtë shtyllës punuese të makinës gjatë procesit të qepjes. Mekanizmin e brendshëm poshtë e përbëjnë pedala dhëmbëzoria transportuese e cila ka për detyrë ta bëjë lëvizjen e materialit në drejtim të distancës në mes dy shpimeve gjatë qepjes. Me vetëlëvizjen e materialit kryhet nën ndikimin e fërkimit në mes të pedaleve të poshtme të transportit dhe materialit i

cili qepet. Pedalja e poshtme transportuese është e dhëmbëzuar për ta lëvizur më lehtë materialin gjatë qepjes. Pedalja e sipërme transportuese lëviz me ndihmën e motorit elektrik, përmes boshtit kryesor, mekanizmi i lakuar e transmeton lëvizjen rrethore në lëvizje të drejtë, dhe si e tillë transmetohet në gjilpërë dhe gjilpëra kryen funksionin e sajë të punës. Pedalja e brendshme e dhëmbëzuar lëviz me anë të motorit elektrik përmes boshtit kryesor. Boshti kryesor është i lidhur në formë lakore (kurbë) me grremçin i cili synon lëvizjen ta transmetojë në aksin lëvizës. Aksi lëvizës është i lidhur me pedalja e dhëmbëzuar në pjesën e poshtme me mekanizëm lakor që ka për detyrë qarkullimin ta transformojë në lëvizje të drejtë.

1.1.6. MEKANIZMI PËR DHËNIEN DHE SHTRËNGIMIN E PENIT

Ky mekanizëm ka për detyrë gjatë procesit të qepjes ta bëjë dhënie dhe shtrëngimin e penit. Pavarësisht nga ky funksion, ky mekanizëm ka për detyrë të mundësojë krijimin e lakut, ta vendosë në mes dy pjesëve përbërëse dhe të mundësojë që të përfitohet shtep.

1. „Gjilpërorja”
2. Koka
3. Foleja e gjilpërës
4. Aksi
5. Mekanizmi i lakuar
6. Aksi për dhënie dhe shtrëngim




Figura 6. Pamja skematike e mekanizmit për dhënie dhe shtrëngim e perit

Kur aksi nr 6 (mekanizëm për dhënie dh shtrëngim) është ngritur lartë, pozita 2, pastaj mekanizmi i gjilpërës lëshohet poshtë në pozitën 1 dhe bën dhënie dhe formimin e lakut. Kur pozita nr 6 lëviz në pozitën 2, pastaj mekanizmi i gjilpërës në pozitën 1, kthehet dhe sjell lakun, ajo vendoset në mes dy pjesëve përbërëse, prej nga formohet shtepi. Ky mekanizëm është i lidhur me mekanizmin e gjilpërës ose vetë ngritjen dhe vendosjen e aksit për dhënie e perit për dhënie dhe shtrëngim.

1.1.7. MEKANIZMI PËR PËRFORCIMIN E GJILPËRËS NË „GJILPËRORE”

Procesi i përforcimit të gjilpërës në „gjilpërore” mund të bëhet në dy mënyra. Mënyra e parë – përforcim i domosdoshëm, dhe mënyra e dytë, përforcim jo i domosdoshëm.

1. „Gjilpërorja”
2. Gjilpëra
3. Elementi përforcues
4. Mbjajtësi





Figura 7. Përforcimi i domosdoshëm dhe jo i domosdoshëm i gjilpërës

Përforcimi i domosdoshëm i gjilpërës për „gjilpërore” kryhet në atë mënyrë që gjilpëra së pari vendoset në mbajtës dhe pastaj në „gjilpërore” dhe përforcohet me një element të caktuar. Ndërsa te përforcimi jo i domosdoshëm gjilpëra drejtpërdrejtë vendoset në „gjilpërore” dhe përforcohet në element të caktuar.

Gjilpëra me „gjilpërore” ka lëvizje të ndryshueshme gjatë momentit të punës.



1, 5, 10, 15 – maksimumi i lëvizjeve të gjilpërës

Figura 8. Lëvizja e gjilpërës gjatë procesit të punës

1.1.8. MEKANIZMI PËR LËVIZJEN E „GJILPËRORES” TE MAKINAT ME SHPEJTËSI TË MADHE

Ky mekanizëm ka për detyrë të bëjë lëvizjen e „gjilpërores”, njëkohësisht edhe gjilpërën, për shkak se gjilpëra është e përforcuar në „gjilpërore”. Ky mekanizëm është i përfaqësuar vetëm te makinat me shpejtësi të madhe 3000 - 6000 r/minutë. Qëllimi i lëvizjes së „gjilpërores” është në fakt që të bëjë sinkronizimin e lëvizjes të gjysmëprodhimit dhe numrin e shpimeve të gjilpërës në të njëjtin numër, për shkak se punëtori nuk mund të bëjë vazhdimisht lëvizjen e gjysmëprodhimit gjatë qepjes. Makina automatikisht e lëviz „gjilpëroren” dhe mundëson qepjen pa mos u formuar shtep i parregullt dhe për të parandaluar dëmtimin në gjysmëprodhit vetë punonjësi. Me këtë i shmanget harxhimit të materialit, gjilpërave, fijen për qepje, e rrit produktivitetin dhe cilësinë e punës të gjysmëprodhimit në nivel të duhur.

1. Boshti kryesor
2. Aksi
3. Boshti
4. Bosht i cili merr lëvizjen
5. Udhëzuesi
6. Mekanizmi i lakuar
7. „Gjilpërorja”
8. Mbikoka-pjesa e sipërme




Figura 9. Pamja skematike e mekanizmit lëvizës të „gjilpërores”

1.1.9. MEKANIZMI I DRUGËZËS

Ky mekanizëm ka për detyrë për të krijuar vjegëzën-lakun*. Gjilpëra me fijen e poshtme dhe të sipërme krijon vjegëzën, vjegëza e krijuar vendoset ndërmjet dy pjesëve përbërëse të saj që të formojnë një tërësi-shtep. Përbërja dhe krijimi i vjegëzës mund të kryhet në dy mënyra:

1.1.9.1 Osciluese

1.1.9.2 Rrotulluese

- nëpërmjet rripit të dhëmbëzuar
- nëpërmjet dhëmbëzorit të shtrirë



Figura 10. Drugëza te makina kantir



Figura 11. Drugëza te makina me shtep të thjeshtë-rëndomtë

1.1.9.1. Lëvizja osciluese

Mekanizmi merr lëvizje prej boshtit kryesor përmes mekanizmit të lakuar. Lëvizja transmetohet prej lëvizjes rrethore, lëvizjes lineare, përmes aksit ndihmës dhe boshtit, transmetohet deri te mekanizmi i drugëzës, ku i njëjti e kryen punën e vetë.




Figura 12. Pamja skematike e mekanizmit me lëvizjen osciluese

1.1.9.2. Lëvizja rrotulluese

Kjo lëvizje mund të kryhet me rripin e dhëmbëzuar dhe dhëmbëzorin e shtrirë.

1. Boshti kryesor
2. Rripat e boshtit kryesor
3. Rripi i dhëmbëzuar
4. Boshti ndihmës
5. Mekanizmi i drugëzës në dy mënyra dhe me ndihmë




Figura 13. Pamje skematike të rripit të dhëmbëzuar

1. Boshti kryesor
2. Dhëmbëzori i shtrirë
3. Aksi
4. Boshti ndihmës
5. Mekanizmi i drugëzës
6. Rripi i dhëmbëzuar




Figura 14. Pamja skematike e dhëmbëzorëve të shtrirë

Dallimi në mes këtyre dy mekanizmave është se njëri mekanizëm direkt e merr fijen e cezës (asura) dhe ka një cezë të madhe që zgjat më shumë ndërsa që të mos e ndërpresë procesin e qepjes më shpesh. Ky lloj i punës është i përfaqësuar te mekanizmi në prani të rripit të dhëmbëzuar. Ndërsa mekanizmi që përmban dhëmbëzorë të shtrirë ka një cezë të vogël – mbështjellës në të cilin ka një sasi të vogël të penit që shpejtë harxhohet gjatë procesit të qepjes dhe është një prej mungesës kryesore të këtij mekanizmi.

1.1.10. MEKANIZMI I GJILPËRËS TE MAKINA ZIG-ZAG

Ky lloj makine dallohet nga makinat e zakonshme vetëm te mekanizmi i gjilpërës. Në këtë njësi mësimore do ta përpunojmë të njëjtën, vetëm se mekanizmat janë të njëjtë si te makinat me shtep të zakonshëm. Këto makina përdoren për qepjen e elementeve dekorative-zbukuruese, ballina, prapanicë, qepje e këpucëve vendore, pjesë të vendosura. Shpesh herë, me këtë makinë qepen këpucë prej materialeve natyrore (lëkurë, peliqe, velur, etj.).

1. Motori elektrik
2. Boshti kryesor-f XI
3. Lidhja dypjesëshe
4. Kushineta - 8
5. Mekanizmi i lakuar
6. Aksi i motorit
7. Mbikoka-pjesa e sipërme
8. Mbajtësi i gjilpërës
9. Boshti për lëvizjen e plakës panel-bregas
- 10 Harqe për transferimin e lëvizjes
- 11 Akse të lidhura-artikuluar
- 12 Pllakë bregore indirekte
- 13 Harku i lartë i panelit
- 14 Dhëmbëzori i shtrirë




Figura 15. Pamje skematike e mekanizmit të gjilpërës te makina zigzag



Figura 16. Mekanizmi i gjilpërës te makina zigzag

Dallimi i mekanizmave të llojeve të tjera të makinave është në mënyrën e lëvizjes të vetë gjilpërës. Gjilpëra te këto makina lëviz në dy kahje dhe atë poshtë-lartë dhe majtas-djathtas. Kjo mënyrë e lëvizjes përfitohet me përdorimin e panelit të lartë që në fakt lejon lëvizjen e gjilpërës në të dy drejtimet. Lëvizja e gjilpërës lart-poshtë bëhet me ndihmën e boshtit kryesor që i jep lëvizje mekanizmi i lakuar. Ndërsa lëvizjen majtas-djathtas bëhet me anë të akseve që janë të lidhur në formë të gogllës me panelin i cili është në formë të kokrrës dhe lejon lëvizjen majtas-djathtas. Pas lëvizjes së kryer lartë-poshtë majtas-djathtas formohet shtepi zigzag.

1.1.11. MEKANIZMI I GJILPËRAVE TE MAKINA DY GJILPËRSHE

Makina dygjilpërshe është një makinë që nga pamja e saj është e njëjtë me makinën me shtep të zakonshëm. Dallimi është vetëm te prezenca e dy gjilpërave te kjo makinë. Ka dy lloje të makinave dygjilpërshe, njëra nga të cilat në pamje është e njëjtë si një makinë me shtep të zakonshëm dhe makina punon në të njëjtin princip si edhe makina dygjilpërshe - kantir që nga konstruksioni është e ndryshme prej të mëparshmes, sepse ajo ka një shtyllë në të cilën është i vendosur mekanizmi i drugëzës dhe për atë quhet edhe makina shtyllë.

Kjo makinë përdoret për qepje dekorative të gjysmëprodhimeve, si dhe çdo përbërje e gjysmëprodhimeve, që në fund të përfitohet bashkëngjitje dhe produkte në përgjithësi –pjesë të sipërme. Gjatë qepjes me dy gjilpëra përfitohen lloje të ndryshme të shtepeve, më saktë numrjen e shpimeve në një centimetër. Makina mund të qepë në varësi të nevojës për fije të hollë apo të trashë. Kryesisht varet nga lloji i materialit që qepet.



Figura 17. Mekanizmi me dy gjilpëra

Karakteristikë të kësaj lloji makine është se ka një mbajtës të gjilpërës dhe një fole në të cilën mund të vendosen dy ose më shumë gjilpëra. Makina ka dy drugëza, çdo njëra prej tyre formon një shtep. Makina mund të ketë më shumë gjilpëra, por nuk mund të ketë më shumë se dy drugëza. Ekziston edhe makinë automatike që punon së bashku në një rrugë të caktuar. Kjo makinë e lehtëson punën dhe për të arritur produktivitet më të madh, më ekonomik në repartin prodhues.

1. Mbajtësi i gjilpërës
2. Foleja
3. Gjilpërat




Figura 18. Pamja skematike e mekanizmit me dy gjilpëra

1.1.12. MEKANIZMI I MAKINËS „NGJITËSE” – PASPULIM

Ngjitja e skajeve kryhet me anë të paspulimit. Ka disa lloje të paspulimit, edhe atë:

1. Paspulim të hapur me ngjitje të mbuluar
2. Paspulim të hapur me qepje të mbuluar
3. Paspulim të mbyllur me qepje dhe ngjitje të mbuluar.

Paspulimi i hapur kryhet me ngjitje dhe qepje të mbuluar. Ngjitja kryhet në mënyrë të thjeshtë, me kthimin e mbuluar në gjysmë dhe e lyer me ngjitës në skaje. Qëllimi i kësaj është t'i mbrojë pjesët e skajeve të ngjitura prej dëmtimit mekanik. Përveç kësaj, kjo është e mbuluar në momentin kur bëhet qepja e pjesëve të përbërësve të sipërm. Mbulesa me qepje kryhet në makinat e qepjes. Ky proces është i komplikuar dhe patjetër të kryhet me vëmendje për shkak se është një mbulesë e hollë që bashkohet me pjesën e sipërme dhe kalon nëpër makinë, së bashku me pjesën e sipërme që qepet. Mbulesa duhet të shtrihet në mënyrë të barabartë në të dy anët për të përfituar kualitet gjatë qepjes. Rezistenca e pjesës së mbuluar nuk është shumë e madhe sepse skaji që mbulohet me qepje është i vendosur në 1 mm nga vetë skaji. Kjo metodë e mbulojës përdoret më së shpeshti te materialet që janë të trasha dhe materialet e holla. Vetëm duhet pasur kujdes përputhshmëria në mes trashësisë së materialit dhe mbulesës të jetë i përshtatshëm për njëra-tjetrën.



Figura 19. Makina për paspulim - „ngjitëse”

Paspulimi i mbyllur me qepje dhe ngjitje paraqet mënyrën më kualitative të mbulimit-paspulimit. Me këtë mënyrë mbulon skajet e pjesëve të zonës, duke mbuluar skajet e veta dhe pjesët e mbyllura të këpucëve.

Mënyra për mbulesë të mbyllur zhvillohet si vijon: vendosen pjesët ballë për ballë të cilat mbulohen në skajin me distancë të skajit në 1 mm nën skajin e pjesës që mbulohet. Kështu mbulesa e vendosur qepet në të gjithë gjatësinë. Pas përfundimit, skaji i lirë i mbulesës kthehet mbi skaj dhe qepet në pjesën që mbulohet dhe ngjitet në ballinë-fytyrë e pjesës që mbulohet. Dhe gjatë procesit të bashkimit të pjesëve të fytyrës me astarin dhe bëhet qepje plotësuese. Kjo qepje quhet kantirim-banding (qepja e skajeve). Kjo mënyrë e mbulimit ndryshe quhet edhe mënyrë franceze. Ky lloj i paspulimit ka një efekt të mirë dhe estetikë të mirë. Si mbulim paspulir mund të përdoren materiale të holla me një trashësi prej 0.8 mm. Por për atë gjerësi e vet duhet të jetë së paku 5 mm.

1.1.13. MEKANIZMA NDIHMËS TE MAKINA ME SHTEP TË ZAKONSHËM

1.1.13.1 Mekanizmi për rregullimin e distancës në mes dy shpimeve

Ky mekanizëm paraqet një ndër mekanizmat kryesor ndihmës në makinë. Ai gjendet në kokën e makinës. Si dhe vetë titulli na tregon, ky mekanizëm përdoret për vendosjen e distancës në mes dy shpimeve të gjilpërës. Varësisht nga lloji i materialit që qepet dhe trashësia e tij janë të zgjedhura në mënyrë të përshtatshme dhe gjatësia në mes të dy shpimeve. Në rast se punohet me material të hollë dhe qepje të këpucëve elegante, bëhet fjalë për më tepër shpime në 1 cm. Por në rast se punohet këpucë dimërore - këpucë me shtep zbukurues, ku përdoret një fije e trashë e konopit, distanca midis dy shpimeve është më e madhe ose numri i shpimeve në 1 cm është më i vogël. Rregullimi i numrit të shpimeve bëhet me dorë, në një pjesë të rrumbullakët që ka të shënuara më shumë distanca me madhësi të ndryshme.



Figura 20. Mekanizmi për rregullimin e distancës në mes dy shpimeve

1.1.13.2. Mekanizmi për mbështjelljen e perit në masurë

Ky mekanizëm është i përfaqësuar te makinat që përdorin fije ndihmëse nga mekanizmi i drugëzës. Në qoftë se kjo është një makinë që përdor një fije të poshtme direkt nga masura, atëherë makina nuk do të ketë nevojë për këtë mekanizëm. Ky mekanizëm është i vendosur afër makinës në tavolinën punuese. Ajo përbëhet nga një rrotë rrethore që lëviz me anë të dorës që lëviz ndaj rripit dhe kyçet me motor elektrik që bën lëvizjen e makinës. Në vetë rrotën rrethore në të cilën vendoset masura – shpulna që vendos fijen e cila mbështillet. Mbështjellja bëhet me dorë të punëtorit, peri lëviz majtas – djathtas, në mënyrë të drejtë për të mbështjellur në masurë. Pas mbështjelljes të perit bëhet vendosja e tij në drugës dhe kur vendoset në drugës atëherë ajo është e gatshme për t'u inkuadruar në punë. Mangësia e këtij mekanizmi është shumë e vogël dhe shpejt vjen deri te harxhimi i fjes së perit gjatë punës, dhe kështu shpesh vjen deri te ndërrimi, mos mbushja e vetë kalemit.



Figura 21. Ndërtimi i mbështjellësit të peri i ulët



Figura 22. Ndërtimi mbështjelljes në perin e poshtëm



Figura 23. Ceza pjesë e poshtme kalemza

1.1.13.3. Mekanizmi për ftohjen e gjilpërës

Ky mekanizëm gjendet në vetë mekanizmin e gjilpërës. Ai shërben për ftohjen e gjilpërës gjatë procesit të qepjes. Ky mekanizëm punon në dy mënyra, d.m.th, ftohja e gjilpërës mund të kryhet në dy mënyra. Me ajër të komprimuar ftohja kryhet pavarësisht nga vetë mekanizmi i gjilpërës, me kanale transportuese e sjell ajrin e ftohtë të komprimuar që bën ftohjen e gjilpërës. Mënyra e dytë, zhytja e gjilpërës në tretje të puferit të caktuar-ftohës. Ky mekanizëm është i pranishëm në shpejtësi të ulët te makinat për qepje, që shërbejnë për materiale me trashësi, materiale të forta, si dhe në raste të përdorimit të fijos të trashë për qepjen e gjoneve dhe pjesëve të tjera të poshtme.

TEMA: II

MAKINA PËR TËRHEQJE – PËRBËRJEN E PJESËS
SË SIPËRME ME TABANICË

2. MAKINA PËR TËRHEQJE – PËRBËRJEN E Pjesës së SIPËRME ME TABANICË

Ky repart merret me montimin-bashkimin, bashkëngjitjen e pjesës së sipërme dhe pjesët e poshtme përbërëse në një tërësi për të përfituar prodhim-mbathje-këpucë. Por, para se të fillojë ky proces, paraprakisht duhet të kryhen disa operacione shtesë që janë të detyrueshme për të marrë këpuca formën e duhur. Në këpucë duhet të shtohet pjesa ngjitëse me gjonin dhe korseta-kapuçi. Radhitja e operacionit për përfitimin e pjesës ngjitëse me gjonin është përshkruar më poshtë:

**Zhytja e materialeve ⇒ prerja e pjesëve ngjitëse me gjonin ⇒ hollimi i skajeve
⇒ para formësimit ⇒ Formësimi**

Përbërja (montimi) i pjesëve të sipërme me pjesët e poshtme në prodhimtari zhvillohet në repart të veçantë - **montimi**. Përbërja kryhet gradualisht, së pari përbëhen pjesët e sipërme, pjesët ngjitëse me gjonin dhe korseta-kapuçi, për të përforcuar pjesën e sipërme me tabanicë, për bashkimin e këtyre pjesëve vendoset një pjesë e mes gjonit për ngjitje, vendoset gjoni shkelës dhe nënthembra - taka. Përbërja, si fazë prodhuese mund të quhet me një emër tjetër-tërheqje dhe përbërje, që të emërohet përbërja e pjesës së sipërme me tabanicë (mbështjellje).

Përfundimi (mbarimi i pjesëve gjysëmprodhim). Kjo fazë mund të konsiderohet si nënfazë e përbërjes - montimit. Mbarimi i këpucëve përfshin operacione të ndryshme mekanike për përfundimin e operacioneve të poshtme, si dhe përpunimet kimike të pjesëve dhe pjesëve të sipërme të mbathjeve-këpucëve.

2.1. MEKANIZMAT TE MAKINAT PËR PARATËRHEQJE DHE TËRHEQJE TË MAJËS

Makina për tërheqjen e pjesës së përparme të mbathjeve-këpucëve – MAJES, ndryshe quhet edhe **IBERHOL MAKINË**.

Makina për parambështjellje ka për detyrë ta bëjë tërheqjen e pjesës së sipërme në kallëp. Pjesa e sipërme merr formën e caktuar pas mbarimit të këtij procesi, ku produkti i përfunduar – mbathja (këpuca) merr pamjen përfundimtare të gjysmëprodhimit. Ky lloj i parambështjelljes pa tërheqje ka një karakter të përkohshëm.

Kjo makinë është e përbërë prej këtyre mekanizmave:

- mekanizmi i darëve- pincat
- mekanizmi për dhënien e gozhdave-thumbave
- mekanizmi për ngulje e gozhdave-thumbave
- mekanizmi i mbajtjes së poshtme

Mekanizmi i darëve pinceta ka për detyrë shtrëngimin e pjesës së sipërme në kallëp dhe ta mbajë në atë pozitë deri sa të aktivizohet mekanizmi për dhënien dhe nguljen e thumbave-gozhdave. Ky mekanizëm punon në 4 faza.




Figura 24. Pamja skematike e paratërheqjes të përparme dhe anësore



Figura 25. aparati Iberhollshpic

Kjo makinë e përfundon operacionin e filluar nga makina e mëparshme, sepse ajo ka një detyrë të përkohshme ta kryej tërheqjen me ndihmën e gozhdave. Në këtë rast, gozhdat hiqen në tërë sipërfaqen e pjesës së përparme të pjesës së sipërme, i vendoset ngjitës me ndihmën e një makine –iberhollshpic. Vihet ngjitës, e njëjta nxehet në temperaturë të caktuar dhe të përgatitur kështu, duke përdorur aparate për bartje, bartet deri te makina që e kryen aplikimin përfundimtar. Me këtë gjysmëprodhim - pjesa e sipërme ngjitet përgjithmonë për tabanin.

Makina Iberhollshpic punon në një princip të ngjashëm me atë të mëparshmen, vetëm se mënyra e përbërjes dhe karakteri i përbërjes është i ndryshëm.

2.2. MEKANIZMAT E DARAVE

Kjo makinë ka për detyrë ta tërheqë pjesën e sipërme në kallëp, si dhe mbështjelljen e saj, derisa të aktivizohet mekanizmi për dhënien dhe nguljen e gozhdave. Ky mekanizëm përdoret për tërheqjen e pjesës së sipërme të modeli i këpucëve me qepje dhe gozhdim.




Figura 26. Mekanizmi i darëve

Gjysmëprodhimi vendoset në mbajtësen e poshtme dhe mbështetet afër mbajtësit anësor. Me aktivizimin e makinës aktivizohen edhe darët-pinca që bëjnë shtrëngimin e pjesës së sipërme me tabanin, dhe pastaj aktivizohet mbajtësi i gozhdave që kryen mbështjelljen e pjesës së sipërme që lëviz pas tij, derisa të aktivizohet mekanizmi për dhënien dhe thumbimin e gozhdave.

2.3. MEKANIZMAT E MBAJTËSIT TË POSHTËM

Ky mekanizëm ka për detyrë të mundësojë përforcimin e gjysmëprodhimit në momentin e nguljes së gozhdave, dhe të mundësojë lëshimin e gjysmëprodhimit nga makina pas nguljes të gozhdave.

1. Aksi kryesor
2. Spiralja
3. Akset e palëvizshëm
4. Pllaka të palëvizshme-fikse
5. Boshti
6. Kushineta
7. Cilindri
8. Pllaka panel
9. Boshti i pllakës panel
10. Aksi
11. Aksi lëvizës
12. Pllaka lëvizëse




Figura 27. Mekanizmi i mbajtëses së poshtme

Cilindri lëviz nëpër sipërfaqen e pllakës së panelit dhe do të takohet me pjesën tjetër dhe pastaj vjen deri te bashkëngjitja e spirales dhe mbajtëses që e përforon gjysmëprodhimin dhe nguljen e gozhdave. Kur cilindri takohet me pjesën e prerë të pllakës panel, vjen deri te lëshimi i spirales dhe lëshohet gjysmëprodhimi dhe nxirret nga makina. Gjysmëprodhimi me pjesën e parë vendoset në lëvizje, kurse në pjesën e thembres në aksin e fiksuar (e palëvizshëm).

2.4. MEKANIZMI PËR DHËNIEN E GOZHDAVE OSE NGJITËSES

Mekanizmi për dhënie e gozhdave ka për detyrë të jep gozhda në momentin kur mekanizmi i darëve kryen mbështjelljen e pjesës së sipërme për rreth tabanës.

1. Boshti kryesor
2. Kutitë e gozhdave-thumbave
3. Govatë
4. Kanalet
5. Pllaka e radhitjes
6. Dhëmbëzori
7. Pllaka e lëvizshme
8. Pllaka e palëvizshme (e fiksuar)
9. Gypat plastikë




Figura 28. Mekanizmi për dhënie e gozhdave

Kutia ku janë të vendosura gozhdat mund të ketë lëvizje oscilatore ose rrethore. Gjatë kësaj lëvizje, kutia me ndihmën e mekanizmit në formë të pirunit, gozhdat bien në prerjet dhe për shkak të peshës së vet, përmes kanalit radhiten në plakën për radhitje. Pllaka e radhitjes punon në 4 takte dhe në secilin takt merr nga 5 gozhda, ashtu që kur mekanizmi do të mbushet, aktivizohet, d.m.th. i merr mekanizmi për ngulje-thumbim.

Përveç këtij mekanizmi për dhënie e gozhdave, ekziston një mekanizëm për të dërguar ngjitës. Ky mekanizëm punon në të njëjtën mënyrë, por në vend të gozhdave, disponon me një tub nëpërmjet të cilit kalon ngjitës që bartet në gjysëmprodhim. Ngjitësi është në granula me përpunim termik dhe shndërrohet në gjendje të lëngshme që është e gatshme për kalimin nëpër vend lëshimin. Pas kësaj kryhet ngjitja dhe bashkimi në mes vete i këtyre pjesëve me ngjitje.

2.5. MEKANIZMI PËR THUMBIMIN E GOZHDAVE

Mekanizmi ka për detyrë të bëjë nguljen e gozhdave në momentin kur mekanizmi i ka dhënë gozhdat.

1. Korniza
2. Mbjajtësit e çekiçit
3. Kushineta
4. Boshti
5. Spiralja për lartësinë e çekiçit
6. Çekiçi
7. Aksi
8. Boshti
9. Cilindri
10. Pllaka bregore
11. Boshti i pllakës bregore lartë
12. Spiralja
13. Rrotulluesi




Figura 29. Mekanizëm për nguljen e gozhdave

Ngulja e gozhdave bëhet në mënyrë që cilindri lëviz në sipërfaqen e pllakës e cila ka aks bregor dhe prerje. Në momentin kur cilindri do të kalojë nëpër pllakën panel, vjen deri te mbledhja e spirales, ku akumulohet forca për nguljen e gozhdave. Në momentin kur cilindri do të vijë te vendet e prera të pllakës bregore vjen deri te lëshimi i spirales, dhe me atë lëshohet edhe mbajtësi i çekiçit e cila bën thumbimin e gozhdave. Çdo mbajtës në vetvete ka dy mekanizma për mbajtjen e çekiçëve.

TEMA: III

**MAKINA PËR TËRHEQJEN E
THEMBRËS-THEMBRA AUTOMATIKE,**

3. KARAKTERISTIKAT E PËRGJITHSHME TË MAKINËS PËR TËRHEQJEN E THEMBRËS

Kjo makinë ka për detyrë ta bëjë tërheqjen dhe përbërjen e pjesës së sipërme me pjesën e tabanicës në pjesën e thembërës. Kjo makinë ndryshe quhet dhe thembër automatike. Tërheqja kryhet me nguljen e gozhdave, edhe atë menjëherë prej 12 deri 24 gozhdave që varet nga lloji i modelit dhe madhësisë së saj. Këtë makinë e përbëjnë këto mekanizma që do t'i mësojmë si të veçanta:

- mekanizmi i mbajtësit të poshtëm
- mekanizmi shtrëngues
- mekanizmi i pllakave
- mekanizmi i mbajtësit të sipërm
- mekanizmi i dhënies së gozhdave
- mekanizmi i nguljes së gozhdave



Figura 30. Thembër automatike

3.1. MEKANIZMI I MBAJTËSIT TË POSHTËM

Ky mekanizëm ka për detyrë që ta mundësojë bartjen e gjysmëprodhimit në shtrënguesin e makinës. Pas mbarimit të tërheqjes në pjesën e thembrës duhet të mundësohet heqja e gjysmëprodhimit prej makinës.




Figura 31. Skema e mekanizmit të mbajtësit të poshtëm

Gjysmëprodhimi, me pjesën e tabanicës i kthyer lartë, vendoset në maje me pjesën e thembrës, kurse në pjesën përpara shtrihet bazamenti nr. 5. Gjysmëprodhimi së bashku me mbajtësin e poshtëm, i vendosur me pjesën e thembrës lartë, duke përdorur një pedale këmbë e vë në lëvizje. Vetë vënia në lëvizje e makinës, mbajtësi i poshtëm bashkë me gjysmëprodhimin e lëviz përpara dhe hyn në shtrënguesin e makinës. Madhësia e majës – fënderi që është në maje të mbajtësit të poshtëm duhet të ketë dimension të caktuar dhe të përshtatshëm në mënyrë ideale, që do t'i përgjigjet hapjes të kallëpit në të cilin është i vendosur gjysmëprodhimi. Aksi nr. 2. lirisht mund të lëviz përreth boshtit nr. 4 dhe në këtë mënyrë mundëson bartjen e gjysmëprodhimit në makinë dhe nxjerrjen nga makina.

3.2. MEKANIZMI SHTRËNGUES

Ky mekanizëm ka për detyrë ta bëjë shtrëngimin dhe përforcimin e gjysmëprodhimit në pjesën e thembrës për kallëpi, në momentin kur mekanizmi i pllakave bën mbështjelljen e lëshimit të pjesës së sipërme në pjesën e thembrës përreth tabanicës që të aktivizohet mekanizmi për dhënie dhe ngulje.

1. Shtrëngimi lëkurës
2. Shiriti i dhëmbëzuar
3. Akset
4. Boshtet
5. Segmente dhëmbëzore
6. Akset




Figura 32. Skema e mekanizmit të shtrëngimit

